



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**04.07.2019, Prishtinë,
Ref:11.06.2019\800-2019**

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Naser Rrustemajt kundër Gazeta Shneta**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, në mbledhjen e tij të mbajtur më 25 qershor 2019, shqyrtoi ankesën e Naser Rrustemajt kundër Gazeta Shneta lidhur me artikullin "Kryetari i Odës së Infermierëve ia cakton rrogën vetes 1500 euro", dhe mori këtë:

V E N D I M

- Ankesa miratohet.

A R S Y E T I M I

Ankuesi pretendon që Gazeta Shneta e ka publikuar shkrimin i cili nuk tregon të vërtetën dhe përmes fotografisë mundohet të bëjë keqinformimin e publikut. Po ashtu ankuesi pretendon që media në fjalë nuk i ka dhënë mundësinë që pala të përgjigjet për atë që është publikuar.

Gazeta ka bërë shkeljen e Kreut II (Raportimi i së vërtetës), dhe Kreut IV (E drejta për t'u përgjigjur) të Kodit të Mediave të Shkruara.

Lajmi është shkruar në Gazeta Shneta dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të ankesës KMSHK gjen se ankesa është e bazuar. Për shkak që media në fjalë nuk i ofron mundësinë ankuesit që të ballafaqohet me argumentet që pretendon shkrimi duke shkel Kreun IV të Kodit të Mediave të Shkruara (e drejta për t'u përgjigjur), gazeta është mjaftuar me nxjerrjen e një fotografie të cilën në një tabelë tregohen sa janë shumat për profesione të ndryshme. Tabela të cilën e paraqiti media është vetëm një draft, dhe jo një vendim përfundimtar i shumave për paga.

Gazeta nuk ka arritur ta argumentojë para publikut se shumat është caktuar nga vet personi (në këtë rast ankuesi).

Në anën tjetër ankuesi përmes paraqitjes së ankesës ka paraqitur para KMSHK-së prova të mjaftueshme që dëshmojnë të kundërtën e asaj që thotë shkrimi.

Andaj, KMSHK vendos që ankesa është e bazuar në tërësi duke miratuar atë.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë, KMSHK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës